



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturën, Omladinit i Sportit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme

Odeljenje za Opštu Upravu

13 Nr. Zyrtar – 2021

-III- Nr. i prot. 1046 Më 12.03.2021
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione për OJQ të cilat operojnë ne teritorin e Komunës së Rahovecit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR PROJEKTE KULTURORE DHE RINORE

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve, që kontribuojnë në promovimin dhe avancimin e kulturës dhe rinisë në komunën e Rahovecit.

1. Komuna e Rahovecit u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare dhe individëve të regjistruar në Repubikën e Kosovës e që veprojnë në komunën e Rahoveci, programi i punës i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në promovimin dhe avancimin e jetës kulturore dhe rinore në komunën e Rahovecit.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:

- Promovimi i kulturës dhe traditave vendore;
- Krijimi i dialogut dhe komunikimit ndërkulturor;
- Vetëdijësimi i rinisë për angazhim social;
- Promovimi i aktiviteteve rinore.

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në promovimin dhe avancimin e jetës kulturore dhe rinore në komunën e Rahovecit, përmes aktiviteteve si më poshtë:

- Ngritjen e kapaciteve për kulturë dhe rini;
- Këshillime dhe mentorime për kulturë dhe rini;
- Nxitjen e komunikimeve ndërkulturore dhe rinore;
- Adresimin e problemeve të çështjeve kulturore dhe rinore në komunë;
- Promovimin e të drejtave njerzore dhe diversitetin kulturor;
- Nxitjen e autoritetetve lokale, institucionet publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave kulturore dhe rinor.

4. Vlera minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është **250 €**, ndërsa shuma maksimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet është deri në **10.000€**.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën **1 prill 2021**.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt.

- Periudha e zbatimit të projektit është deri në fund të vitit 2021.
- E njëjtë OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.
- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të, që janë të regjistruar në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës, respektivisht në komunën e Rahovecit, së paku një (1) vit para datës së publikimit të kësaj thirrje publike.
- OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë.
- OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislaconit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përbushur detyrimet kontraktuale komunës së Rahovecit, si dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiar publike.
- Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rrëth pagesës së kontributeve dhe tatatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit: <https://kk.rksgov.net/rahovec/shpalljet/>.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: komuna e Rahovecit, *Rr. "Dëshmorët e Pashtrikut", pn., Zyrën e pranimit në katin e parë në objektin e Komunës sporteli nr 7.*

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

Do të konsiderohen përmes mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: muharem.a.morina@rks-gov.net, jo më vonë se 10 ditë para skadimit të ftesës publike.

Rahovec, 12/03/ 2021

